



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	16.08.2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSACK	5691/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.930/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.930/2022 të datës 19.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

[redacted] kundër organit të punësimit/Instituti i Kosovës për Administratë Publike-MPB, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.930/2022 e datës 19.10.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Prot.444 i datës 14.10.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] është i punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, sipas Akt emërimit me numër Nr.1965 të datës 18.11.2013 në pozitën "Drejtore i Departamentit të Administratës".

Fillimisht me datën 21.07.2017, Drejtoresha e Përgjithshme ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.303 sipas së cilit ankuesit i ka aprovuar kërkesën për punë sekondare në këtë institucion, ndërsa me datën

27.08.2018, po ashtu nga kjo e fundit është nxjerrë Vendimi Nr.Prot.020 sipas të cilit ankuesit i është aprovuar kërkesa për punë sekondare në këtë institucion prej datës 01.09.2018 deri më 01.09.2019. Po ashtu me datën 18.12.2020, Drejtoresha e Përgjithshme e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, ka nxjerrë Vendimin Nr.469, sipas së cilit ankuesit i 'u është aprovuar kërkesa për punë sekondare (20 orë në javë) në këtë institucion prej datës 18.12.2020 deri në një vendim tjetër në lidhje me këtë çështje. Ndërsa me datën 14.10.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike, ka nxjerrë Vendimin Nr.444, sipas së cilit e ka shfuqizuar vendimin e datës 18.12.2020 me numër protokolli 469 për lejimin e angazhimit të ankuesit për punë sekondare në këtë institucion.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.444 të datës 14.10.2022, nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike, me datën 19.10.2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6298/2022, me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse me këtë vendim kemi aplikim të gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale.

Me datën 30.11.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.176/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit [redacted] edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Me datën 13.12.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin A.nr.930/2022, sipas të cilit e ka pezulluar procedurën lidhur me ankesën e ankuesit të datës 19.10.2022 e parashtruar në Këshill, me arsyetimin se lënda e ankuesit në fjalë ka pasur të bëjë me shfuqizimin e Vendimit me Nr.Prot.444 të datës 14.10.2022, i lëshuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike me të cilin është shfuqizuar Vendimi me Nr.Prot.469 i datës 18.12.2020 lidhur me ndërprerjen e angazhimit për punë sekondare në këtë institucion, e cila lëndë është ndërlidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.827/2022 të datës 26.09.2022 e parashtruar në Këshill e që ka qenë parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore ndërsa përmes vendimit A.nr.827/2022 të datës 22.11.2022, ishte aprovuar pjesërisht ankesa e ankuesit dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim te organi i njëjtë për vendimmarrje, konform këtij vendimi për rishqyrtim komisioni disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme kishte nxjerrë vendimin Nr.2100 të datës 23.12.2022, me që rast ankuesit i kishte shqiptuar masën disiplinore "*ndalim i ngritjes në detyrë ,duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 4 vjeqare*" i njëjti më datë 25.01.2022 përmes ankesës A.nr.152/2023 kishte parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi në këshill, ndërsa përmes vendimit A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 këshilli i kishte refuzuar ankesën të njëjtit dhe kishte lënë në fuqi vendimin Nr.2100 të datës 23.12.2022 të komisionit disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 6298/2022, të datës 19.10.2022; Vendimin e numër Nr.Prot.444 të

datës 14.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në IKAP; Akt emërimit e ankuesit me numër Nr.Prot.1965 të datës 18.11.2013 në IKAP; Vendimin me numër Nr.Prot.469 të datës 18.12.2020 nga Drejtoresha e Përgjithshme në IKAP; Librezën me numër 646-1/21/08 të ankuesit nga handikos të datës 22.02.2017; Vërtetimin me numër 646-1/21/09 të datës 26.01.2021 nga handikos për ankuesin; Ekspertizën-vlerësimin mjekësor me numër 646-1/21/010 të datës 26.01.2009 për ankuesin; Autorizimin e datës 18.10.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.10.2022 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin-PDP të datës 06.08.2012 lidhur me përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Plotësimin e përgjigjes në ankesën e ankuesit të datës 01.11.2022 nga IKAP së bashku me e-mailat e bashkangjitur zyrtar të datave: 28.09.2022, 08.10.2022, 10.10.2022, 18.10.2022, 19.10.2022, 14.10.2022, 21.10.2022, 24.10.2022; Orarin lidhur me lëndët e mbajtura të viti 2022/2023 për vitin e dytë-semestri i tretë në fakultetin e shkencave sociale në kolegjin AAB; Vendimin me numër Nr.Prot.303 të datës 21.07.2017 nga Drejtoresha e përgjithshme e IKAP-it; Vendimin me numër Nr.Prot.020 të datës 27.08.2018 nga Drejtoresha e përgjithshme e IKAP-it; Vendimin VK.nr.176/2022 të datës 30.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Vendimin me numër A.nr.930/2022 të datës 13.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimin me numër A.nr.827/2022 të datës 22.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimin Nr.2100 të datës 23.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankesën A.nr.152/2023 të 25.01.2023, Vendimin me numër A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se janë të papabuzuara pretendimet ankimore të ankuesit, **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit duke ndërlidhur edhe me përmbajtjen e vendimit A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ju referue nenit 5 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (i cili Ligj ka qenë në fuqi në kohën e cila ndërlidhet me lëndën e ankuesit përkatësisht vendimet përmes së cilëve ju kishte aprovuar kërkesa ankuesit për punë sekondare në këtë institucion-*IKAP*, e që ishin vendime nga viti 2017, 2018, 2019 dhe 2020) e që përcaktohej se: *“Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit”*, ndërsa sipas Rregullores (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht me nenin 15 parashihej se: *“Me veprimtari të jashtme të nëpunësit civil kuptojmë çdo lloj angazhimi të rregullt ose të kohë pas kohshëm jashtë institucionit me pagesë ose pa pagesë. Nëpunësi civil nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare dhe që cenon në çfarëdo mënyre, realizimin e objektivave të institucionit. 3. Nëpunësi civil për angazhimin e jashtëm duhet t'i njoftoj paraprakisht udhëheqësin drejtues dhe njësinë e personelit”*. Ndërlidhur me dispozitat në fjalë dhe çështjen e cila është objekt shqyrtimi i ankesës së ankuesit, Kolegji ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.152/2022 të datës 24.03.2022, ka

konstatuar faktin se ankuesi për periudhën nga gushti i vitit 2017 deri në dhjetor të vitit 2020 (me përjashtim të muajit shkurt-gusht 2019) ka mbajtur dy vende të punës me pagë primare në IKAP dhe në Kolegjin AAB (me pagë të plotë), fakt i konfirmuar edhe nga Agjencia Kundër Korrupsionit si organ kompetentë për vlerësim të kësaj çështje përmes shkresës me Nr. protokoll DLK 0203/2278/22 të datës 26.05.2022, poashtu pas shqyrtimit të shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se i njëjti pas periudhës së muajit dhjetor 2020 punën në IKAP e ka të deklaruar si punë sekondare, ndërsa punën me orar të rregullt në Kolegjin AAB si punë primare.

Bazuar në shkresat e lëndës, duke ju referue edhe konstatimeve të kolegjit të këshillit në Vendimin A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji ka gjetur se ankuesi punën në shërbimin civil në pozitën e "Drejtorit të Departamentit të Administratë" pranë Institutit të Kosovës për Administratë Publike, e ushtron si punë sekondare që nga korriku 2017 e tutje, ndërsa angazhimin e tij në Kolegjin Privat AAB (si institucion jopublik/jo buxhetor) e ushtron si punë primare dhe me orar të plotë, fakt ky i konfirmuar përmes shkresës Ref.nr.251/2021 të datës 13.04.2021 të lëshuar nga Kolegji AAB ku sipas përmbajtjes citohet "Bujar Thaqi është i angazhuar si profesor i rregullt në këtë kolegji dhe ka kontratë valide nga data 01.10.2017 deri më datë 30.09.2021 me mundësi vazhdimi".

Marrë parasysh përcaktimin ligjor si më sipër, Kolegji konstaton se marrëdhënia e punës në shërbimin civil është marrëdhënie primare dhe se nëpunësi civil mund të angazhohet në veprimtari/punë jashtë shërbimit civil vetëm në rast se ky angazhim nuk sjell rrethana të konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e punës në shërbimin civil dhe nuk pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare apo realizimin e objektivave të institucionit. Për më tepër Kolegji thekson faktin se marrëdhënia e punës në shërbimin civil ushtrohet me orar të plotë të punës, ose me orar të shkurtuar në rast të sëmundjes apo pa aftësisë punuese të nëpunësit civil të konstatuara nga organi kompetent.

Sipas provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi posedon dokumentacionin mjekësor përmes së cilit konfirmohet aftësia e kufizuar e të njëjtit dhe se i njëjti sipas kartelës së nëpunësit civil nga muaji gusht 2019 deri në dhjetor 2020 (përjashtimisht shkurt-gusht 2019) ka marrë pagë të plotë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe nga Kolegji Privat AAB, veprime këto që në vlerësimin e Kolegjit bien ndesh me nenin 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, më të cilin përshihet se: "1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbartuesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër", rrethana dhe konstatime të konfirmuara në vendimin A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndërsa mbi bazë të arsyeve si më sipër edhe ishte lënë në fuqi vendimi Nr.2100 i datës 23.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në raport me ankuesin.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi deri me datë 18.12.2020 nuk kishte përcjell në ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe Thesarin e Kosovës formularët përkatës lidhur me deklarin e pagës primare dhe sekondare, edhe pse

bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së Drejtorit të Departamentit të Administratës i njëjti është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me çështjet financiare/buxhetore, prokurimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij të punës ndërsa mos përmbushja e detyrave të punës dhe shkeljet e dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil janë konfirmuar edhe përmes vendimit të këshillit A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023.

Bazuar si më lartë, Kolegji vlerëson se Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike referuar edhe konstatimeve dhe përmbajtjes së vendimit A.nr.152/2023 të datës 24.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.444 të datës 14.10.2022 lidhur me shfuqizimin e Vendimit me Nr.469 të datës 18.12.2020 lidhur me lejimin e angazhimit të ankuesit në punë sekondare në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, sepse në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material, në këtë formë duke rikthyer ligjshmërinë sa i përket kësaj çështje që është objekt i kësaj ankese, ndërsa pretendimet tjera të ankuesit nuk kishin ndonjë relevancë në lidhje me këtë çështje sa i përket përmbajtjes së vendimit përfundimtarë në lidhje me këtë ankesë.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.930/2022, datë 16/08/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.